

KËRKIME GJUHËSORE

Rexhep OSMANI

SHQIPJA LETRARE NË SHTETIN E PAVARUR SHQIPTAR

1. Niveli i ulët i studimeve gjuhësore në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe më pas, gjatë periudhës së Pavarësisë, e pengoi dukshëm njësimin e gjuhës letrare shqipe. Gjuhëtarët e huaj, që u morën me problemin e studimit të shqipes, arritën rezultate të mira në fushën e fonetikës historike, të morfologjisë historike dhe të leksikut historik të shqipes, por gjuha e gjallë e popullit, d.m.th. dialektet dhe të folmet shqipe mbetën jashtë sferës së interesimit të tyre. Mungesa e studimeve dialektologjike ndikoi që njohuritë e dijetarëve më të mirë të mos jepnin gjithnjë rezultate të dëshirueshme për normën e shqipes standarde. Nuk dihej për fenomenet e ndryshme gjuhësore e sidomos për nivelin e shtrirjes së tyre në të folmet shqipe. Veç kësaj, elementet e veçanta gjuhësore vështroreshin të ndara dhe jo në lidhshmërinë e natyrshme të tyre. Të gjitha këto në masë të konsiderueshme e penguan dhe e ngadalësuan normëzimin e gjuhës letrare shqipe.

2. Një faktor tjetër i rëndësishëm, që pengoi normëzimin më të hershëm të gjuhës së njësuar letrare shqipe, që mungesa e institucioneve të organizuara shkencore, të cilat në mënyrë kolektive do të merreshin me trajtimin e këtij problemi (të standardizimit të shqipes) në periudhën kohore para Luftës II Botërore. Megjithatë, studiuesit shqiptarë, të shtyrë nga dëshira e flaktë për ta ngritur kulturën shqiptare më lart, arrinin që të informoheshin për punën e njëri tjetrit edhe në lëmin e normëzimit të shqipes. Në etapën e Rilindjes Kombëtare munguan institucionet arsimore dhe shkencore, që do të luanin rol të rëndësishëm për arritjen e këtij qëllimi. Shkollat fillore, që ishin hapur, nuk mund të luanin këtë rol. Ky rol u kompensua sado pak me punën që bënë shoqëritë shqiptare, sidomos në kolonitë e ndryshme dhe gazetat e revistat që dolën, qoftë në kuadër të këtyre shoqërive, qoftë në kuadër të veprimtarisë së pavarur të patriotëve shqiptarë nëpër koloni, shumë prej të cilëve e dhanë edhe jetën për ta arritur këtë qëllim.

3. Në kohën kur lindi shteti i pavarur shqiptar, që pritur që gjuha shqipe të normëzohej me hapa më të shpejtë dhe pa pengesa. Sukseset nuk munguan dhe çështja e shqipes letrare u shtrua mjaft gjerësisht dhe u shënuan suksese për një periudhë të shkurtër kohore, që qenë rezultat i përpjekjeve të intelektualëve shqiptarë, të cilët u përpoqën ta vazhdonin traditën e rilindësve dhe bënë hapa të tjerë të rëndësishëm përpara për normëzimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe kah formimi definitiv i formës së saj njëtrajtëshe. Edhe Qeveria e Ahmet Zogut më 1923 pranoi me dekret shtetëror një gjuhë të vetme letrare shqipe mbi bazën e elbasanishtes, të normëzuar në Komisinë Letrare të Shkodrës (1916-18), por këtë e zhvleftësuan qeveritarët monistë pas Luftës II Botërore, pasi që më parë nuk e patën pranuar as shkollat dhe qarqet toke të Shqipërisë Jugore.

4. Konfuzioni, i cili që krijuar ndër intelektualët shqiptarë në të dy etapat e zhvillimit të Rilindjes Kombëtare, madje edhe në periudhën midis dy luftërave botërore, i shkaktuar nga metodat dhe teoritë e ndryshme gjuhësore evropiane, që faktor tjetër, që nuk lejonte mundësi për njësimin e një gjuhe të vetme letrare.

Shkollat linguistike evropiane, me gjithë përparimet që kishin arritur, nuk mbështeteshin në faktorët historiko-shoqërorë, pa të cilët nuk mund të kuptohej drejt asnjë histori e gjuhës letrare. Në truallin e shqipes ky problem ishte shumë kompleks, sepse e kishin komplikuar rrethanat historiko-shoqërore, që e përcojnë popullin shqiptar dhe gjuhën e tij. Pas Luftës II Botërore qenë krijuar kushte më të mira dhe qenë bërë parapërgatitje, që hapën rrugën për planifikimin e gjuhës së standardizuar shqipe, pavarësisht që ndonjë studiues nuk dëshiron të pranojë një realitet të këtillë dhe mohan çdo gjë të krijuar në monizëm.

Në këtë kohë, pas Luftës II Botërore, edhe në Kosovë u krijuan disa kushte për lëvrimin e gjuhës letrare shqipe. Në këto anë që respektohet për dy dhjetëvjetësh gjuha letrare shqipe mbi gegërishten e përgjithshme, që kishte një bazë më të gjerë sesa baza e të dy varianteve paralele letrare që qenë përdorur në Shqipëri (elbasanishtja dhe shkodranishtja). Shtimi i institucioneve arsimore e shkencore si dhe i studiuesve të rinj, të përgatitur për t'i hyrë studimit të gjithanshëm dhe cilësor të të gjithë lëmenjve të shkencës gjuhësore shqiptare, kishin ndikuar, që rruga e planifikimit të mëtejme të shqipes standarde të vihej në baza të shëndosha shkencore dhe të ecte me hapa më të shpejtë përpara.

5. Institucionet shkencore të Shqipërisë dhe më vonë edhe të Kosovës pas 1968-s njësimi të gjuhës shqipe i kushtuan kujdes të merituar. Ata këtë punë e vunë në krye të detyrave, duke e bërë objektiv kryesor, megjithëqë këtë punë fillimisht e bënë ndarazi. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Tiranës formoi Komisionin e përhershëm të drejtshkrimit nën drejtimin e Aleksandër Xhuvanit qysh në vitin 1947, i cili qëllim të përhershëm kishte njësimin e gjuhës letrare shqipe. Ky komision, që pësoi edhe ndonjë ndryshim gjatë kalimit të kohës, ishte i ndihmuar vazhdimisht edhe nga një numër i madh studiuesish të shquar të shqipes, të cilët dhanë kontribut të vlefshëm, duke shpejtuar procesin e njësimi të gjuhës letrare shqipe. Merita e veçantë e të gjithë atyre që punuan drejtpërdrejt për njësimin e gjuhës letrare shqipe qëndronte aty se ditën të shfrytëzonin çdo gjë, që ishte pozitive nga e kaluara për drejtshkrimin, duke gjetur zgjidhje të drejta hap pas hapi gjer në Kongresin e Drejtshkrimit, i cili u mbajt në Tiranë më 1972.

6. Disa probleme të normëzimit të gjuhës letrare shqipe u përcojnë edhe në etapën pas Luftës II botërore, mirëpo këto probleme do të evitohen gradualisht dhe do të krijohen kushte për formimin e një gjuhe të vetme letrare shqipe. Posa u formua Komisioni i drejtshkrimit hartoi një projekt ortografie, që e lëshoi në diskutim publik më 1948. Ky projekt-drejtshkrimi u diskutua dhe u kritikua nga shumë anë. Duhet të përmendet vlerësimi kritik, që i pati bërë këtij projekt-drejtshkrimi Simon Shuteriqi¹ në një material të gjerë. Kritikën ndikuan që Komisioni i drejtshkrimit t'i përvishej punës me këmbëngulje edhe më të madhe. Pas vërejtjeve të pranuar, dhe botimit të një drejtshkrimi tjetër të ri më 1949, në vitin 1951 doli Drejtshkrimi i parë i gjuhës shqipe pas Luftës II Botërore i cili ende nuk mund të zgjidhte përfundimisht problemin e njësimi të shqipes letrare².

¹ J. Kastrati, *Për historinë e ortografisë shqipe*, Përparimi 1971, nr. 1, f. 607.

² Instituti i Shkencave, *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1951, f. 27.

SHQIPJA LETRARE NË SHTETIN E PAVARUR SHQIPTAR

Më 1952 çështja e formimit të gjuhës së përbashkët letrare shqipe u shtrua me seriozitet edhe më të madh. Në këtë vit u bënë dy sesione shkencore për normëzimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe, ndërsa më 1953 Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë i Tiranës organizoi Konferencën Kombëtare të Drejtshkrimit³, që bëri jehonë në truallin e shqipes. Puna e suksesshme e kësaj Konference, që vazhdoi edhe për dy vjet më pas, dha si rezultat një mjet të ri të normëzimit të shqipes letrare - *Drejtshkrimin e ri të gjuhës shqipe* (1956), i cili edhe zyrtarisht e mbyllte fazën e parë të përpjekjeve për njësimin e shqipes në shtetin shqiptar.

7. Për njësimin e gjuhës letrare shqipe u bënë përpjekje të rëndësishme edhe në Kosovë, ku u zhvilluan më 1952 Mbledhja e Parë e Drejtshkrimit, më 1957 Mbledhja e Dytë dhe më 1963 Mbledhja e Tretë e Drejtshkrimit⁴. Gjersa në dy mbledhjet e para u diskutuan çështje problemore, që dilnin në zbatimin e normave letrare në Kosovë, në Mbledhjen e Drejtshkrimit të 1963-s, që u bë në Prishtinë, doli ortografia e parë e plotë e botuar në Kosovë, që ishte një sukses i madh për lëvrimin dhe njësimin e gjuhës shqipe. Mbledhjet e drejtshkrimit të mbajtura në Kosovë, megjithë ndonjë dobësi që mund të kenë pasur dhe me gjithë pengesat e panumërta të shkaktuara nga qarqet sllave me disponim antishqiptar, e quan normëzimin e shqipes më përpara dhe arritën disa suksese të konsiderueshme, të cilat në gjuhësinë shqiptare janë pranuar plotësisht⁵.

8. Në vitet '60 të shekullit XX planifikimi i shqipes standarde u zgjerua në shkallë kombëtare, duke u mbështetur gjithnjë e më gjerë në baza të qëndrueshme shkencore, pasi që me lëvrimin e gjuhës tani filluan të merren edhe shtresat e gjera të intelektualëve shqiptarë. Bashkëveprimi ndërdialektor, që kishte filluar gjatë Rilindjes, në këto vite u zgjerua më tej, duke dhënë rezultate pozitive për normëzimin e gjuhës standarde shqipe. Të gjitha këto do të gjejnë vend të gjerë në Projekt-drejtshkrimin e 1967-s. Projekti i drejtshkrimit i 1967-s, i botuar në Tiranë, karakterizohej për bazën shkencore që kishte në krahasim me të gjitha drejtshkrimet e mëparshme. Rëndësia e këtij projekt-drejtshkrimi qëndronte në faktin se ky ishte drejtshkrimi i parë i gjuhës së njësuar/ standarde shqipe që botohej pas Luftës II Botërore. Ky projekt i drejtshkrimit ia lehtësoi punën Kongresit të Drejtshkrimit, i cili njësoi gjuhën letrare shqipe për shqiptarët.

9. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) vendosi përfundimisht fatin e gjuhës së standardizuar shqipe, por puna për normëzimin definitiv të saj nuk mori fund. Ata që u morën me problemin e planifikimit dhe të standardizimit të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh edhe artikujt që qenë shkruar sa u diskutua publikisht *Projekti i drejtshkrimit i 1967-s* dhe kumtesat e lexuara në Kongresin e Drejtshkrimit, i eliminuan shumë të meta, që qenë vërejtur në Projekt-drejtshkrimin e 1967-s dhe botuan *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* (1973) - mjetin

³ J. Kastrati, *Për historinë e ortografisë shqipe*, Përparimi 1971, nr. 1, f. 607.

⁴ I. Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare në Kosovë*, Kongresi i Drejtshkrimit, Prishtinë 1974, f. 127.

⁵ R. Ismajli, *"Në gjuhë" dhe "për gjuhë"*, Dukagjini, Pejë 1998, f. 174.

më të rëndësishëm të shqipes standarde. Pak më vonë u botua edhe gramatika normative e gjuhës shqipe (morfologjia dhe sintaksa) dhe fjalori i gjuhës së sotme letrare shqipe. Në këtë mënyrë me botimin e këtyre mjeteve kodifikuese të gjuhës standarde shqipe qenë tejkaluar pengesat, që nuk kishin lejuar standardizimin e mëhershëm të gjuhës shqipe.

10. Po të përshkruhet mënyra e kapërcimit të pengesave për standardizimin e shqipes, do të mund të konstatohej se në nënsistemin e fonetikës dallimet dialektore, të cilat vëreheshin edhe brenda ish-varianteve letrare të shqipes, qenë tejkaluar, duke u normëzuar sistemi i zanoreve gojore. Zanoret hundore dhe sistemi i zanoreve të gjata qenë lënë jashtë normës së shqipes standarde. Grupet e zanoreve, po ashtu, janë elemente të përbashkëta, që dalin në të dy ish-variantet letrare (*ie, ye, ue/ua*). Disa të folme të dialektit të gegërishtes grupet e zanoreve *ie, ye, ue* i kanë monoftonguar dhe sot ato dalin si zanore të thjeshta, por këto kanë një përhapje të kufizuar, ndërsa kristalizimi i tyre në ish-variantet letrare si grupe të plota zanoresh që bërë që nga Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-18). Grupet vokallike *ue/ua* kanë gjetur vend në normën e shqipes së standardizuar, duke zënë pozita të caktuara në sistemin emëror, te mbiemrat, te foljet dhe te disa ndajfolje. Kështu, bie fjala, krahas emrave të vepruesit që dalin me një prapashtesë të tipit *-s* (*khs.: mësues, shkues, punues* etj.) dalin edhe emra me grupin vokalik *ua* si *muaj, buall, truall* etj. Po kështu edhe mbiemrat: *i punuar - i punueshëm, i lexuar-i lexueshëm, i detyruar - i detyrueshëm* etj. bashkëjetojnë në sistemin mbiemëror⁶, edhe pse kanë burime të ndryshme dialektore.

11. Dallimet me karakter dialektor, që dilnin në sistemin e bashkëtingëlloreve, u tejkaluan në normën e shqipes së standardizuar në atë mënyrë, që disa veçori të toskërishtes letrare nuk gjetën vend në normë, si p.sh. zhdukja e kundërvënies midis bashkëtingëlloreve dridhëse *r - rr*, shurdhimi i bashkëtingëlloreve fundore ose përpara bashkëtingëlloreve të pazëshme në trup të fjalës etj. Edhe grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng, ngj*, që dalin në të gjitha të folmet e toskërishtes dhe në një pjesë të gegërishtes, u ngritën në normë. Një numër i kufizuar të folmesh (si ato të Kosovës), këto grupe bashkëtingëlloresh i kanë asimiluar në bashkëtingëllore të thjeshta, mirëpo ky fenomen gjuhësor ka një përhapje të kufizuar dhe me të drejtë është lënë jashtë normës së gjuhës së standardizuar shqipe, sepse, veç të tjerash, e errëson edhe vetë strukturën semantike të fjalës. Problemi i rotacizmit është zgjidhur në atë mënyrë që ky fenomen gjuhësor është pranuar në normë, por në normën e shqipes së standardizuar kanë hyrë edhe trajtat pa rotacizëm, të cilat janë shumë më të përhapura. Edhe neologjizmat, që qenë krijuar në kohën e Rilindjes e më pas, sikurse edhe ndërkombëtarizmat, të cilat gjetën vend në normën e shqipes së standardizuar, nuk kanë rotacizëm.

⁶ Instituti i Gjuhësisë, Rregullat e drejtëshkrimit të shqipes – projekt, Tiranë 1967, f. 66 – 67.

SHQIPJA LETRARE NË SHTETIN E PAVARUR SHQIPTAR

12. Këto shpjegime të përgjithësuara argumentojnë se në të shumtën e rasteve në nivel të normës së shqipes standarde janë ngritur njësitë gjuhësore që kanë baza të përbashkëta në të dy dialektet e shqipes, dhe të varianteve letrare të saj. Grupin e dytë të njësive gjuhësore të bazës dialektore të shqipes e përbëjnë njësitë gjuhësore, të cilat nuk janë plotësisht të përbashkëta. Ato ndryshojnë në ish-variantet letrare, sidomos në nësistemin e fonetikës. Nga këto elemente gjuhësore më shumë janë marrë ato, që i takonin variantit të toskërishtes sesa ato të gegërishtes (raporti është 13:8 për toskëri-shten)⁷. Prandaj konstatimi se në bazën e gjuhës standarde shqipe është vënë varianti letrar i toskërishtes nuk mund të jetë i qëndrueshëm, sepse nuk i përgjigjet realitetit. Në kushtet konkrete të shqipes së standardizuar, në bazën e së cilës janë vënë, në rend të parë, elementet e përbashkëta të të dy dialekteve dhe të ish-varianteve letrare të tyre, nuk ka qenë e mundur që të maten saktësisht veçoritë dialektore të njërit a të tjetrit variant letrar, prandaj del e kuptueshme, se elementet e njërit variant mund të mbizotërojnë. Në rastin konkret të normëzimit të shqipes standarde mbizotërojnë veçoritë e ish-variantit letrar të toskërishtes, sepse ato tek e fundit ruajnë më mirë strukturën e njësive gjuhësore të shqipes e madje dalin unike në të gjitha të folmet e tij.

13. Në nënsistemin e morfologjisë mbizotërimi i elementeve të toskërishtes zvogëlohet dukshëm. Ka pasur kërkesa që emrat e tipit *bari-barinj*, *fqi-fqinj*, *mulli - mullinj* etj. në trajtën e shumësit të dilnin me prapashitesën trajtëformuese *-j* dhe jo me *-nj*. Argumentet për arsyetim kanë qenë të shumëllojshme, një ndër të cilët ka qenë edhe ky, se një fenomen i këtillë është realizuar plotësisht në të gjitha të folmet e gegërishtes, që paraqet tendencën e zhvillimit të mëtejme të vetë strukturës së shqipes. Gjatë normëzimit të formave të shumësit me *-nj* nuk është marrë për bazë një element, siç është - eliminimi i hundorësisë, e cila, siç dihet, si fenomen gjuhësor është lënë jashtë normës letrare.

14. Normat e gjuhës letrare shqipe janë mjaft të mocme. Ato kanë një moshë disashekullore dhe fillojnë atëherë kur nis të shkruhet gjuha letrare shqipe. Normat e shqipes letrare në periudhën para Rilindjes Kombëtare kanë qenë të lidhura ngushtë me anën praktike të normëzimit, ndërsa ajo e periudhës kombëtare të kohës së Rilindjes Kombëtare e më pas shënonin edhe hapat e parë të trajtimit teorik të normës së shqipes letrare/standarde.

15. Gjuha standarde shqipe po i bën katër dekada të funksionimit të saj si gjuhë standarde e popullit shqiptar dhe ka funksionuar e vazhdon të funksionojë me sukses, sidomos në trajtën e shkruar të saj në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e kudo ku ka shqiptarë etnikë. Qëllimi kryesor i rilindësve dhe i patriotëve të tjerë shqiptarë për njësimin e plotë të gjuhës letrare shqipe ishte arritur. Ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur brenda kombit shqiptar si dhe përparimi i madh që kanë pësuar shqiptarët dhe të tjerët shtron nevojën e rimarrjes së normës së gjuhës standarde shqipe për zgjerimin e saj, sidomos në leksik dhe terminologji për ta aftësuar atë që të kryejë me sukses të gjitha detyrat që shtrohen përpara saj.

⁷ A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore, të drejtshkrimit të saj, Kongesi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Prishtinë 1974, f. 38.